



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 10, datë 28.12.2020

**PËR**  
**MIRATIMIN E KUFIJVE TË ZONAVE TË MBROJTURA**

Në mbështetje të neneve 7, 9, 10 dhe 16 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, shkronjës “ë” të pikës 6 të nenit 10 të Ligjit Nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kufijve dhe zonimin e brendshëm të zonave të mbrojtura, të listuara si më poshtë:
  - 1.1. Alpet e Shqipërisë-Park Kombëtar;
  - 1.2. Bredhi i Hotovës-Dangëlli-Park Kombëtar;
  - 1.3. Butrinti-Park Kombëtar;
  - 1.4. Divjakë-Karavasta-Park Kombëtar;
  - 1.5. Llogara-Park Kombëtar;
  - 1.6. Lurë- Mali i Dejës-Park Kombëtar;
  - 1.7. Mali i Dajtit-Park Kombëtar;
  - 1.8. Mali i Tomorrit-Park Kombëtar;
  - 1.9. Prespa-Park Kombëtar;
  - 1.10. Shebenik-Park Kombëtar;
  - 1.11. Karaburun-Sazan-Park Kombëtar Detar;
  - 1.12. Balloll - Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.13. Bogovë- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.14. Bredhi i Kardhiqit-Rrëzoma- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.15. Bredhi i Sotirës- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.16. Bredhi i Zhulatit- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.17. Cangonji- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.18. Dardhë-Xhyrë- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.19. Karaburun- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.20. Gërmenj- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.21. Korab- Koritnik- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.22. Kune -Vain-Patok-Fushëkuqe-Ishëm- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;
  - 1.23. Liqeni i Shkodrës- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;

- 1.24. Liqeni i Ulzës- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.25. Lugina e Gjergjevicës- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.26. Lumi Vjosa- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.27. Lugina e Shalës- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.28. Mali me Gropa- Bizë-Martanesh- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.29. Munella- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.30. Polis- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.31. Qafështamë – Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.32. Stravaj- Sopot- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.33. Syri i Kaltër- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.34. Zagori- Park Natyror / Rezervë Natyrore e Menaxhuar;  
1.35. Bjeshka e Oroshit - Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;  
1.36. Bredhi i Drenovës-Sinicë- Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;  
1.37. Guri i Nikës-Lenie-Valamarë- Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;  
1.38. Krastë-Verjon- Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;  
1.39. Kuturman- Qafë Bushi- Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;  
1.40. Liqeni i Pogradecit- Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;  
1.41. Lumi i Bunës-Velipojë- Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;  
1.42. Rrushkull- Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;  
1.43. Bisht Kamëz- Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;  
1.44. Nartë-Pishë Poro- Peizazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur;


2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë:

- 2.1. Harta e kufijve të zonave të mbrojtura;  
2.2. Kufijtë elektronikë, në format vektorial të zonave të mbrojtura (CD).

3. Gjatë hartimit të planeve sektoriale, planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga përcaktimet e këtij vendimi, si dhe pasi të këtë hyrë në fuqi vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave që e shpall të mbrojtur zonën mjedisore të përcaktuar në pikën 1.
4. Çdo dokument planifikimi në fuqi, që bie ndesh me këtë vendim, duhet të ndryshohet në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, pasi të këtë hyrë në fuqi vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave që e shpall të mbrojtur zonën mjedisore të përcaktuar në pikën 1.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe të gjitha autoritetet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit që preken nga ky vendim.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

